

TEST

Secila pyetje ka nga 2 pike.

1. Subjekti i veprës penale “Fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale” është:

- a. Prokurori
- b. Oficeri i policisë gjyqësore
- c. a dhe b
- d. çdo shtetas i cili kryen një kallëzim/ankim kundër një personi që dihet që është i pafajshëm

2. Juridiksioni universal, nuk zbatohet për këtë veprë penale:

- a. Krime kundër njerëzimit
- b. Gjenocid
- c. Pjesmarrje në organizatë kriminale
- d. Financim terrorizmi.
- e. Torturë.

3. Në lidhje me pezullimin e hetimeve, nuk është i saktë pohimi:

- a. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme
- b. Vendimi i arsyetuar i njoftohet vetëm viktimës ose personit që ka bërë kallëzimin, të cilët mund të bëjnë ankim
- c. Ankimi në gjykatë bëhet brenda 10 ditëve nga marrja e dëgjimit mbi vendimin e prokurorit
- d. Kundër vendimit të gjykatës që shqyrton këtë kërkesë nuk lejohet ankim

4. Në lidhje me ballafaqimin, nuk është i saktë pohimi:

- a. Ballafaqimi lejohet vetëm ndërmjet personave që janë pyetur më parë
- b. Ndalohet ballafaqimi i të pandehurit të rritur me viktimën e mitur
- c. Ndalohet ballafaqimi i të pandehurit të rritur me dëshmitarin e mitur.
- d. Ndalohet ballafaqimi i dy dëshmitarëve të mitur.

5. Është masë sigurimi pasuror:

- a. **Sekuestroja Preventive**
- b. Garancia pasurore
- c. Konfiskimi
- d. Dënimi me gjobë

6. Mbrojtja e detyrueshme nuk i sigurohet:

- a. Të pandehurit nën moshën 18 vjec
- b. Të pandehurit shtetas të huaj që nuk njeh gjuhën shqipe**
- c. Të pandehurit të hetuar për veprën penale të kryera nga grupi i strukturuar kriminal
- d. Të pandehurit gjatë procedurës së marrjes së kampionit biologjik.
- e. Personit të arrestuar ose i ndaluar gjatë procedurës së marrjes në pyetje.

7. Lidhur me Urdhërin penal të dënimit, është i vërtetë pohimi:

- a. Gjykata shqyrton kërkesën dhe vendos brenda 10 ditëve nga depozitimi i saj, në seancë në prani të të pandehurit dhe prokurorit
- b. Gjykata në çdo rast duhet të vendos pa i kthyer aktet prokurorit
- c. Gjykata nuk mund të ndryshojë dënimin e caktuar nga prokurori**
- d. Urdhëri penal ngarkon të dënuarin me pagimin e shpenzimeve të procedimit
- e. Vendimi për miratimin e urdhërit penal kundërshtohet në gjykatën e apelit

8. Në lidhje me afatet e paraburgimit, është i vërtetë pohimi:

- a. Gjatë hetimeve paraprake mund të zgjatet jo më shumë se 1 vit
- b. Gjatë hetimeve paraprake mund të zgjaten me vendim të arsyetuar të prokurorit
- c. Nuk pezullohen gjatë fazës së hetimeve paraprake**
- d. Mund të pezullohen kur është urdhëruar ekspertimi i gjendjes mendore të të pandehurit
- e. Mund të pezullohen gjatë fazës së hetimeve paraprake për shkak të veprimeve apo kërkesave të padrejta të bëra nga i pandehuri

9. Në lidhje me sekuestron konservative, nuk është i saktë pohimi:

- a. Vendoset kur ka arsye të bazuara për të menduar se nuk ka garanci për pagimin e shpenzimeve procedurale

- b. Sekuestroja e vendosur me kërkesë të prokurorit është e vlefshme dhe për paditësin civil
- c. Vendoset vetëm mbi bazën e një vendimi gjyqësor
- d. Kur i pandehuri ofron dorëzani ose kapar për të garantuar detyrimin, gjykata nuk e vendos sekuestron
- e. **Sekuestroja zbatohet nga policia gjyqësore, sipas mënyrave të përcaktuara në K.Pr.Penale.**

10. Sigurimi i provës, është i vërtetë pohimi:

- a. **Kërkesa për sigurimin e provës mund të paraqitet në fillim të seancës paraprake**
- b. Prokurori nuk mund të vendosë zgjatjen e hetimeve paraprake me qëllim sigurimin e provës
- c. Viktima mund t'i drejtohet me kërkesë gjykatës për sigurimin e provës kur arsyeton interesin e saj të ligjshëm
- d. Nuk mund të kërkohet sigurimi i provës nga viktima akuzuese
- e. Nuk mund të kërkohet sigurimi i provës për kryerjen e një ekspertimi apo eksperimenti gjyqësor

11. Nuk është masë e sigurimit personal ose pasuror:

- a. Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të një veprimtarie të caktuar profesionale ose afariste
- b. **Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor**
- c. Ndalimi dhe detyrimi për të qëndruar në një vend të caktuar
- d. Garancia pasurore
- e. Sekuestroja preventive

12. Nuk klasifikohen si shkelje e rëndë akti dhe sjellja e mëposhtme nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore:

- a. Zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve të oficerëve të Policisë Gjyqësore gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj
- b. **Shkelja e rregullave të etikës**
- c. Braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për më shumë se 3 ditë;

- d. Thyerja e disiplinës në punë, në mënyrë të përsëritur dhe pas paralajmërimit të dhënë me shkrim nga eprori;
- e. Mosinformimi i prokurorit për ecurinë e hetimeve nga oficeri drejtues, që ka për detyrë të informojë kryesisht;
- f. Fakte dhe sjellje të tjera që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e punonjësit të Policisë Gjyqësore

13. Për shkeljet e rënda ndaj oficerit të policisë gjyqësore jepet kjo masë disiplinore

- a. Vërejtje me shkrim
- b. Vërejtje me paralajmërim
- c. Ulje në detyrë me afat nga 3 muaj deri në 1 vit**
- d. Pezullim nga detyra deri në 6 muaj
- e. Largim nga detyra ose cdo masë tjetër e barazvlefshme me të

14. Çmuarja e pavlefshmërisë relative, nuk është i saktë përcaktimi:

- a. Gjatë hetimeve paraprake çmuarja e pavlefshmërisë bëhet nga gjyqtari hetimeve paraprake**
- b. Pavlefshmëria nuk merret parasysh kur pala e interesuar ka hequr dorë shprehimisht nga kundërshtimi i saj ose ka pranuar pasojat e aktit
- c. Pavlefshmëria nuk merret parasysh kur është shkaktuar nga vetë pala, ose kur ajo nuk ka asnjë interes në ngritjen e saj.
- d. Pavlefshmëria e lajmërimeve, komunikimeve dhe njoftimeve nuk merret parasysh në qoftë se pala e interesuar është paraqitur ose ka refuzuar të paraqitet
- e. Pavlefshmëria nuk merret parasysh kur pala ka përfitur nga e drejta, ushtrimin e së cilës akti i pavlefshëm synon të mbrojtë

15. Nuk është dënim plotësues:

- a. Ndalimi për të drejtuar automjete
- b. Detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor
- c. Humbja e përgjegjësisë prindërore
- d. Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale
- e. Heqja e dekoratave dhe titujve të nderit
- f. Detyrimi për të riparuar dëmin civil të shkaktuar**

16. Kuptimi, objekti dhe çmuarja e provave. Gjenerali pohimin e saktë:

- a. Provat kanë vlerë të paracaktuar nga ligji
- b. Ekzistenca e një fakti në çdo rast mund të nxirret nga disa indicje
- c. Nuk janë objekt provash faktet nga të cilat varet zbatimi i normave procedurale
- d. Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë nëse prova vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit.**
- e. Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë vetëm nëse prova vlen për të vërtetuar pafajsinë e të pandehurit.

17. Në lidhje me kufinj të lejimit të përgjimit, nuk është i saktë përcaktimi:

- a. Përgjimi i komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni lejohet kur procedohet për krimet e kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet
- b. Përgjimi i komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni lejohet kur procedohet për çdo veprë penale me dashje kur kryhet me anën e mjeteve të telekomunikimit apo përdorimit të teknologjive informatike ose telematike.
- c. Regjistrimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike lejohet vetëm kur procedohet për vepra të kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se tre vjet
- d. Përgjimi i komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni lejohet kur procedohet për veprat penale në kompetencë lëndore të Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.**

18. Marrja në pyetje e personit të arrestuar, është i vërtetë pohimi:

- a. Gjykata jo më vonë se 48 orë nga zbatimi i masës merr në pyetje personin për të cilin është vendosur arresti në burg
- b. Gjykata brenda 3 ditëve nga zbatimi i masës merr në pyetje personin ndaj të cilit është vendosur një masë ndaluese.
- c. Gjatë debatit gjyqësor palët kanë të drejtë të paraqesin prova, duke përfshirë dhe provat me dëshmitar
- d. Prokurori nuk mund të marrë në pyetje personin ndaj të cilit është zbatuar masa përpara se gjykata të procedojë me marrjen në pyetje.**
- e. Në përfundim të seancës së marrjes në pyetje nuk mund të vendoset revokimi i masës së sigurimit, por vetëm zëvendësimi i saj

19. Nuk klasifikohet si dënim plotësues sipas Kodit të Drejtësisë Penale Për Të Mitur:

- a. Ndalimi për kryerjen e një veprimtarie
- b. Përmbushja e detyrimeve të caktuara
- c. Qëndrimi në shtëpi
- d. Ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative**
- e. Kryerja e një pune në interes publik

20. Dorëheqja e mbrojtësit nga mbrojtja e të pandehurit , është i vërtetë pohimi:

- a. Ka efekt për organin procedues nga momenti i komunikimit të dorëheqjes
- b. Ka efekt derisa mbrojtësi i ri i zgjedhur ose i cakuar të jetë njohur me aktet e çështjes dhe provat.**
- c. Ka efekt deri në momentin që i pandehuri ndihmohet nga një mbrojtës i ri i zgjedhur ose i cakuar kryesisht.
- d. Rregullohet nga norma të ndryshme nga ato të revokimit të mbrojtësit
- e. Passjell në cdo rast pezullimin e procedimit penal, me përjashtim të administrimit të provave që mund të çojnë në pafajësinë e të pandehurit.

21. Në rastin e veprave penale të kryera pjesërisht jashtë shtetit kompetenca tokësore përcaktohet :

- a. nga vendi i qëndrimit
- b. nga vendi i arrestimit
- c. duke patur parasysh prokurorinë që ka regjistruar e para kompetencën tokësore
- d. duke respektuar rregullat e përgjithshme të kompetencës tokësore**
- e. nga vendi i dorëzimit të të pandehurit
- f. nga vendi i banimit të të pandehurit
- g. duke zbatuar rregullat e përgjithshme të kompetencës lëndore

22. Në lidhje me ekspertimin, nuk është i vërtetë pohimi:

- a. Nuk lejohet ekspertimi për të përcaktuar karakterin dhe personalitetin e të pandehurit.
- b. Nuk lejohet ekspertimi për të përcaktuar cilësitë psikike që nuk varen nga shkaqe patologjike
- c. Mendimi i ekspertit në çdo rast jepet me shkrim
- d. Kur faktet janë veçanërisht komplekse afati i dhënë ekspertit mund të zgjatet vetëm një herë**

- e. Afati maksimal dhënë ekspertit nuk të mund të kaloj afatin prej 6 muajsh.
- f. Eksperti mund të zëvendësohet kur nuk pranohet kërkesa e tij për zgjatjen e afatit të kryerjes së ekspertimit.

23. Prokurori mund të refuzojë të drejtën e viktimës për informim. *Nuk* është i saktë pohimi:

- a. interesi i ruajtjes së fshehtësisë së hetimit tejkalon interesin e viktimës
- b. interesi i të pandehurit tejkalon interesin e viktimës
- c. viktima nuk është pyetur ende si dëshmitar
- d. kur kërkohet informacion në lidhje me vendosjen, vazhdimin, zëvendësimin apo heqjen e masave të sigurimit ndaj të pandehurit**

24. Dorëzimi i kontrolluar, *është* i vërtetë pohimi

- a. autorizohet nga prokurori mbi marrëveshjen e bërë nga oficeri i policisë gjyqësore
- b. autorizohet nga oficeri i policisë gjyqësore dhe vlerësohet nga prokurori
- c. autorizohet nga prokurori, me kërkesë të autoriteteve të huaja**
- d. autorizohet nga gjykata mbi bazën e kërkesës së prokurorit
- e. autorizohet nga prokurori duke u vlerësuar më pas urdhëri i prokurorit në gjykatë

25. Bashkëpunimi me drejtësinë, nuk është i vërtetë pohimi

- a. mund ta fitoj statusin i pandehuri që akuzohet për një krim që dënohet në maksimum jo më pak se 7 vjet burgim, i kryer në bashkëpunim.
- b. dëshmia e tij duhet të jetë provë vendimtare
- c. të dhënat duhet të jepen brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes
- d. marrëveshja mund të lidhet në çdo fazë dhe gjendje të procedimit deri sa vendimi penal mos të ketë marrë formë të prerë**
- e. prokurori mund t'i kërkoj gjykatës përjashtimin e bashkëpunëtorit të drejtësisë nga dënimi